



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 208, Datë 11.12.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERDY ENERGY”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 131/3 Prot, datë 09.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ERDY ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1232 Prot, datë 27.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “ERDY ENERGY” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, **plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”, **plotësuar;**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, **plotësuar.**
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
 - Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar me përjashtim të:

Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërma “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse).

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8,
 - gërmat “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve);
 - gërma “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti);
 - gërma “c” (Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur),

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ERDY ENERGY” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5- vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI